# Alpiq Energy Albania SH.P.K.

## Pasqyrat Financiare
## për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA:

| | FAQE |
|---|---|
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| BILANCI KONTABËL | 2 |
| PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE | 3 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 4 |
| PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË | 5 |
| SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE | 6 - 16 |

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**
**Më 31 Dhjetor 2014**

| | Shenime | Dhjetor 31,2014 | Dhjetor 31,2013 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | | | |
| **Aktive afatshkurtra** | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e saj | 4 | 9,224,641 | 7,601,873 |
| Llogari të arkëtueshme | | - | - |
| Llogari te tjera te arketueshme | 5 | 11,479,590 | 11,033,279 |
| Parapagime dhe shpenzime të shtyra | 6 | 764,195 | 582,144 |
| Inventari | | - | - |
| **Total Aktiveve Afatshkurtra** | | **21,468,427** | **19,217,296** |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 7 | 513,153 | 504,695 |
| **Total aktive afatgjata** | | **513,153** | **504,695** |
| **Total Aktive** | | **21,981,579** | **19,721,991** |
| **DETYRIMET** | | | |
| **Detyrime afatshkurtra** | | | |
| Hua afatshkurtra | 8 | 16,466,450 | 16,473,500 |
| Llogari te pagueshme tregetare | 9 | 3,661,088 | 2,182,663 |
| Grante, te ardhura te shtyra, te tjera detyrim | | - | - |
| Llogari te pagueshme te tjera | 10 | 823,299 | 405,132 |
| **Total Detyrime afatshkurtra** | | **20,950,837** | **19,061,295** |
| **Detyrime afatgjata** | | | |
| Hua afatgjata | | - | - |
| **Total Detyrime afatgjata** | | **-** | **-** |
| **Totali i detyrimeve** | | **20,950,837** | **19,061,295** |
| **Kapitali aksionar** | | | |
| Kapitali aksionar | 11 | 17,625,000 | 17,625,000 |
| Rezerva ligjore | | - | - |
| Fitime te mbartura | | (16,964,304) | (17,326,985) |
| Fitimi i ushtrimit | | 370,046 | 362,681 |
| **Total kapitali aksionar** | | **1,030,742** | **660.696** |
| **Totali i kapitalit dhe detyrimeve** | | **21,981,579** | **19,721,991** |

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16,të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Anastasia Shtylla( Krivosheeva)
Administrator

ALPIQ
Alpiq Energy Albania Sh.p.k
NUIS: K 91906013 R

MAZARS Shpk
Hartues PF

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket", No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

**Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve**
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

| | Notes | Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 | Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|---|
| Te ardhura | 12 | - | - |
| Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit | | - | - |
| Shpenzime personeli | 13 | (3,367,237) | (3,266,604) |
| Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi | 14 | (122,561) | (157,173) |
| Shpenzime te tjera | 15 | (5,297,672) | (5,242,163) |
| **Fitimi operativ** | | **(8,787,470)** | **(8,665,940)** |
| Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto | 17 | 9,157,516 | 9,028,621 |
| **Total shpenzime financiare** | | **9,157,516** | **9,028,621** |
| **Fitimi para tatimit** | | **370,046** | **362,681** |
| Shpenzime tatim fitimi i shtyre | | - | - |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | | - | - |
| **Fitimi i vitit** | 18 | **370,046** | **362,681** |

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Anastasia Shtylla( Krivosheeva)
Administrator

ALPIQ
Alpiq Energy Albania Sh.p.k
NUIS: K 91906013 R

MAZARS Shpk
Hartues PF

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket", No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

**Pasqyra e Levizjeve te Kapitalit**
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

| | Kapitali aksionar | Fitime /(Humbje) te akumuluara | Fitime/ (Humbje) te Ushtrimit | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Më 01 Janar 2013** | **17,625,000** | **(17,689,212)** | **362,227** | **298,015** |
| Fitimi i vitit | | | 362,681 | 362,681 |
| Transferim ne fitime te mbartura | | 362,227 | (362,227) | - |
| **Më 31 Dhjetor 2013** | **17,625,000** | **(17,326,985)** | **362,681** | **660,696** |
| Fitimi i vitit | - | - | 370,046 | 370,046 |
| Transferim ne fitime te mbartura | | 362,681 | (362,681) | - |
| **Më 31 Dhjetor 2014** | **17,625,000** | **(16,964,304)** | **370,046** | **1,030,742** |

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u aprovuan nga administratori i Alpiq Energy Albania sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 12 Mars 2015 nga:

Anastasia Shtylla( Krivosheeva)
Administrator

ALPIQ
Alpiq Energy Albania Sh.p.k
NUIS: K 91906013 R

MAZARS Shpk
HartuesPF

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket", No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@ mazars.al

## Pasqyra e Fluksit të Parasë
## Më 31 Dhjetor 2014

| | Shenime | Dhjetor 31, 2014 | Dhjetor 31, 2013 |
|---|---|---|---|
| **Flukset e parasë nga aktivitetet operative** | | | |
| **Fitimi para tatimit** | | 370,046 | 362,681 |
| *Axhustime për zërat jo-monetare:* | | | |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi | | 122,561 | 157,173 |
| Te ardhura(humbje) nga shitja e AAM-ve | | - | - |
| Prvizione per borxhin e keq | | - | - |
| Te ardhura nga interest | | 247,296 | 247,990 |
| Diferenca konvertimi te parealizuara | | (54,895) | 96,143 |
| **Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues** | | | |
| *Ndryshimi ne kapitalin qarkullues* | | | - |
| Ndryshimi ne inventar | | - | - |
| Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera | | (398,466) | (264,227) |
| Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera | | 1,896,592 | 64,757 |
| Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra | | (182,051) | (281,150) |
| Ndryshimi ne te ardhura te shtyra | | - | - |
| **Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative** | | **2,001,083** | **383,368** |
| Interesa te paguara | | (247,296) | (247,990) |
| Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit | | - | - |
| | | **(247,296)** | **(247,990)** |
| **Aktivitetet investuese** | | | |
| Blerje te aktiveve afatgjata material | | (131,019) | (10,500) |
| Shitje e aktiveve afatgjata jo-materiale | | - | - |
| **Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues** | | **(131,019)** | **(10,500)** |
| **Ndryshimi neto i mjeteve monetare** | | **1,622,768** | **124,878** |
| Mjetet monetare ne fillim te periudhës | | 7,601,873 | 7,476,995 |
| **Mjetet monetare ne fund te periudhës** | | **9,224,641** | **7,601,873** |

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Anastasia Shtylla( Krivosheeva)
Administrator

ALPIQ
Alpiq Energy Albania Sh.p.k
NUIS: K 91906013 R

MAZARS Shpk
Hartues PF

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket", No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al . info@ mazars.al

## 1. TË PËRGJITHSHME

"Alpiq Energy Albania shpk është themeluar si një kompani me përgjegjësi të kufizuar me 06/07/2009 dhe eshte rregjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Objekti i aktivitetit të kompanisë është Transport dhe shitje e energjise. Organizimi i tregut te energjise. Import dhe eksport si dhe veprimtari te ngjashme me to (p.sh. pjesmarrje ne shperndarje jashte kufijeve dhe ankande). Shitje, prodhim, perfaqesim tregtar dhe agjensi.

Zyra qëndrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën "4 Deshmoret", Sky Tower, Business Center, Kati 3, Tirane, Shqiperi.
Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte 2 punonjës (2013: 2 punonjës).

## 2. BAZAT E PËRGATITJES

### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me legjislacionin kontabel dhe tatimor ne Shqiperi. Pasqyrat Financiare janer përgatitur ne perputhje me Ligjin Nr. 9228 date 29 Prill 2004 « Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare » dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2).

### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.
Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

## 3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave te huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

| | **31 dhjetor 2014** | **31 dhjetor 2013** |
|---|---|---|
| **Kurset e këmbimit** | | |
| Euro/Lek | 140.14 | 140.20 |
| Usd/Lek | 115.23 | 101.86 |

### 3.2 Instrumenta financiarë

*Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

*Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*ii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.
Normat e amortizimit per efekt fiskal për vitin aktual jane si më poshtë:

| **Aktive** | **Përqindja** |
|---|---|
| Pajisje zyre dhe informatike | 25% |
| Mobilje zyre | 20% |
| Mjete Transporti | 20% |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### 3.4 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit.

### 3.5 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.6 Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

### 3.7 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Norma e aplikuar ne keto pasqyra financiare per vitin 2014 eshte 15% ( 2013:10%)

## 4. MJETE MONETARE

Teprica e likujditeteve per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Mjete monetare në Lek | **9,207,031** | **146,988** |
| *Arka* | 124,367 | 146,505 |
| *Banka* | 9,082,664 | 483 |
| Mjete monetare në valutë | **17,610** | **7,454,885** |
| *Arka* | 11,133 | 6,480 |
| *Banka* | 6,477 | 7,448,405 |
| **Totali** | **9,224,641** | **7,601,873** |

## 5. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta per Tatim fitimin e parapaguar, TVSH-ne dhe te drejta per t'u arketuar nga te trete si me poshte:

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Paradhenie per punonjesit | 57,608 | 54,548 |
| TVSH per t'u rimbursuar | 1,589,897 | 1,329,872 |
| Te tjere debitore | 9,484,305 | 9,301,079 |
| Tatim Fitimi I parapaguar | 347,780 | 347,780 |
| **Totali** | **11,479,590** | **11,033,279** |

## 6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Shpenzime te periudhave te ardhshme | 276,187 | 171,126 |
| Roaming Deposit ( Vodafone) | 56,500 | 56,500 |
| Paradhenie per qera | 184,688 | 119,170 |
| Parapaguar Tatim burim | 11,472 | - |
| Garanci per qera | 235,348 | 235,348 |
| **Totali** | **764,195** | **582,144** |

## 7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

| | MOBILJE DHE ORENDI | KOMPJUTERA | TOTALI |
|---|---|---|---|
| ***Kosto*** | | | |
| Gjendja më 31 Dhjetor 2012 | 747,345 | 554,696 | 1,302,041 |
| Shtesa | - | 10,500 | 10,500 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | 19,158 | 14,415 | 33,573 |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2013** | **728,187** | **550,781** | **1,278,968** |
| Shtesa | | 131,018 | **131,018** |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | - | - | - |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2014** | **728,187** | **681,799** | **1,409,986** |
| ***Amortizimi i akumuluar*** | | | |
| Gjendja më 31 Dhjetor 2012 | 361,439 | 289,240 | **650,679** |
| Amortizimi i vitit | 75,685 | 66,047 | **141,732** |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | 9,684 | 8,454 | **18,137** |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2013** | **427,440** | **346,833** | **774,273** |
| Amortizimi i vitit | 60,149 | 62,419 | **122,568** |
| Nxjerrje jashtë përdorimit | - | - | - |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2014** | **487,590** | **409,252** | **896,841** |
| *Vlera neto kontabël* | | | |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2012** | **385,907** | **265,456** | **651,362** |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2013** | **300,747** | **203,948** | **504,695** |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2014** | **240,597** | **272,547** | **513,153** |

## 8. HUAMARRJE AFATSHKURTRA

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Huamarrje afatshkurter | 16,466,450 | 16,473,500 |
| **Totali** | **16,466,450** | **16,473,500** |

## 9. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Furnitorë | 3,661,088 | 2,182,663 |
| **Totali** | **3,661,088** | **2,182,663** |

## 10. DETYRIME TE TJERA

Detyrimet te tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Te pagueshme ndaj punonjesve | 289,732 | 306,765 |
| Sigurime Shendetsore & Shoqerore | 58,825 | 48,861 |
| Tatim mbi te ardhurat personale( TAP) | 75,750 | 43,269 |
| Te tjere debitore/kreditore | 398,992 | - |
| Tatim ne burim | - | 6,237 |
| **Totali** | **823,299** | **405,132** |

## 11. KAPITALI AKSIONAR

**Kapitali themeltar**
Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 17,625,000 leke.

**Fitimi i ushtrimit**
Shuma prej 370,046 leke perfaqeson fitimin e vitit te mbyllyr më 31 Dhjetor 2014.

## 12. TË ARDHURAT

Shoqeria gjate vitit 2014 nuk ka realizuar te ardhura.

Të ardhura të deklaruara në sistemin elektonik te tatimeve gjatë vitit 2014 janë në vlerën 1,930,721 leke, te cilat jane si rezultat i deklarimit te autofatures si ne Librin e Shitjeve dhe ne Librin e Blerjeve, ndersa efekti i saj ne pasqyrat financiare eshte zero.

| | Dhjetor 31, 2014 |
|---|---|
| **Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne** | |
| Qarkullim i tatueshem | 1,930,721 |
| Zbriten Autofaturimet 2014 | (1,930,721) |
| **Shuma e qarkullimit e korrektuar** | - |
| Sipas Pasqyrave Financiare me 31.12.2014 | - |
| **Diferenca** | - |

## 13. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

Shpenzimet e personelit deklaruar në Drejtorinë Tatimore janë 3,761,620 lekë. Mospërputhja me shumën 774,480 lekë e shpenzimit të pagës bruto të deklaruar në FDP vjen si rezultat i pagës së papaguar të administratorit e cila llogaritet vetëm për efekt sigurimesh dhe nuk paguhet.

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Pagat e personelit | 2,986,640 | 2,919,916 |
| Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 380,597 | 346,688 |
| **Totali** | **3,367,237** | **3,266,604** |

## 14. AMORTIZIMET E ZHVLERESIMET

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Shpenzime amortizimi | 122,561 | 157,173 |
| **Totali** | **122,561** | **157,173** |

## 15. SHPENZIME TË TJERA

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Blerje Energji,avull,uje karburant | 55,407 | 56,844 |
| Shpenzime qeraje | 1,426,921 | 1,430,712 |
| Mirëmbajtje dhe riparime | 3,000 | - |
| Blerje te ndryshme,kancelari etj | 10,000 | 16,366 |
| Sherbime nga te trete | 888,440 | 844,935 |
| Anetaresime | 115,026 | 349,576 |
| Shpenzime te tjera | 2,110,133 | 1,826,440 |
| Shpenzime postare dhe telekomunikacioni | 355,986 | 423,051 |
| Shpenzime transpoti | 76,000 | 68,500 |
| Komisione bankare | 165,638 | 187,644 |
| Taksa te ndryshme | 91,121 | 38,095 |
| **Totali** | **5,297,672** | **5,242,163** |

## 16. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane analizuar si me poshte:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Shpenzime per interesa | (247,296) | (247,990) |
| Te ardhura te tjera nga penalitetet kontraktuale | 9,452,657 | 9,301,079 |
| Humbje nga kembimet valutore | (580,582) | (549,919) |
| Te ardhura nga kembimet valutore | 532,737 | 525,451 |
| **Totali** | **9,157,516** | **9,028,621** |

## 17. TATIM FITIMI

Shoqëria është subjekt i Tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të Tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.
Legjislacioni Tatimor dhe Ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| **Fitim i vitit përpara tatimit** | **370,046** | **362,681** |
| Humbje e mbartur | (2,513,584) | (11,252,902) |
| Shpenzime të pazbritshme | 414,104 | 358,934 |
| **Fitimi fiskal para tatimit** | **(1,729,434)** | **(10,531,286)** |
| Tatimi mbi fitimin | - | - |

## 17. TATIM FITIMI (VAZHDIM)

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 | % | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 | % |
|---|---|---|---|---|
| Fitimi i vitit para tatimit | 370,046 | **100%** | **362,681** | 100% |
| Tatim fitimi me normën e aplikueshme | 55,507 | 15% | 36,268 | 10% |
| *Rregullimet për diferencat:* | | | | |
| Shpenzime të pazbritshme | 62,116 | 17% | 35,893 | 8% |
| **Totali** | **117,623** | **32%** | **72,162** | **20%** |

## 18. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë të detajuara si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| **Bilanci kontabël** | | |
| ***Të arkëtueshme nga palët e lidhura*** | | |
| Alpiq Energy Se Ceki | 9,452,657 | 9,405,714 |

***Të pagueshme nga palët e lidhura***

| | Më 31 dhjetor 2014 | Më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Alpiq Energy Se Ceki | 3,363,364 | 1,682,400 |
| ***Hua*** | | |
| Atel Energy Switzerland | 14,014,000 | 14,020,000 |
| Atel Energy Se Prage | 2,452,450 | 2,453,500 |

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| **Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve** | | |
| ***Te ardhura te tjera financiare*** | | |
| Te ardhura nga penalitete kontraktuale | 9,452,657 | 9,301,079 |
| Shpenzime kontraktuale fikse | (1,681,680) | (1,684,779) |
| Te ardhurat dhe shpenzime nga interesat | (247,296) | (247,990) |

## 19. ANGAZHIME DHE PASIGURI

*Çeshtje gjyqesore*
Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*
Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

*Detyrime te ardhshme per qerane operative*

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Brenda nje viti | 1,429,428 | 1,430,040 |
| Me shume se nje vit, me pak se pese vjet | - | - |
| **Totali** | **1,429,428** | **1,430,040** |

## 20. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Anastasia Shtylla( Krivosheeva)
Administrator

ALPIQ
Alpiq Energy Albania Sh.p.k
NUIS: K 91906013 R

MAZARS Shpk
Hartues PF

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket", No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@ mazars.al